



## Memorandum Mirëkuptimi

në mes

### OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe egjiptianëve” dhe Komunës së Prishtinës

Prishtinë, më 01.06.2017

#### 1. Qëllimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejshëm Memorandumi) lidhet në mes të OJQ - “Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve” dhe Komunës së Prishtinës. *Projekti për përfshirjen sociale dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian* ka si qëllim kryesor koordinimin e veprimeve të përbashkëta për afirmimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë.

#### 2. Objektivat e Projektit

Projekti për përfshirjen sociale dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ka objektivat kryesore, si vijon:

- **Shërbimet sociale** - informimi i anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas lidhur me akterët lokal në fushën e shërbimeve sociale (Qendra për Punë Sociale, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale),
- **Edukimi** - ngritja e vetëdijes për mosbraktisjen e shkollimit nga radhët e anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas,
- **Regjistri civil** - identifikimi i anëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas që nuk janë të regjistruar në regjistrin civil dhe asistencën në aplikim për dokumentet përkatëse.
- **Projekte potenciale** - identifikimin dhe procedimin e projekteve të mundshme në lagjet ku banojnë anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas.

### **3. Roli dhe përgjegjësitë e palëve**

OJQ – VoRAE – Projekti për përfshirjen sociale dhe permirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas do të jetë përgjegjës në implementimin e aktiviteteve, si vijon:

- Ndërmarrjen e aktiviteteve informuese lidhur me shërbimet sociale, përkatësisht rastet e rënda sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas t'u ndihmoi në aplikim në institucionet përkatëse,
- Organizimi i fushatave vetëdijesuese për mosbraktisjen e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas,
- Asistencë anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas për t'u regjistruar në regjistrin civil të Republikës së Kosovës,
- Identifikimin dhe procedimin e projekteve në lagjet ku jetojnë anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas,
- Informim nga vizitat në terren për aktivitetet vetëdijesuese, përkatësisht shpërndarjen e informatave dhe realizimin e kampanjave vetëdijesuese.

Komuna e Prishtinës do të mbështesë asistencën e plotë në implementimin e aktiviteteve të lartpërmendura, përmes:

- Konsultimeve të përbashkëta në fushën e shërbimeve sociale, edukative, të regjistrin civil dhe projekteve potenciale për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas,
- Dokumentet e regjistrin civil për anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas do të jenë falas një muaj brenda vitit,
- Shkëmbimi i informatave të ndryshme lidhur me projektet e komuniteteve, dhe
- Mundësinë e qasjes së stafit profesional, me qëllim të koordinimit të punëve lidhur me implementimin e objektivave të përmendura.

### **4. Kohëzgjatja e Memorandumit**

Kohëzgjatja e këtij memorandumit është nga 01.06.2017 deri më 31.12.2018. Ky memorandum mund të shkëputet edhe para përfundimit të kësaj periudhe kohore, në rast se paralajmërohet në afat kohor prej 1 muaji nga cilado palë në bashkëpunim.

OJQ "VoRAE" – Projekti i përfshirjes sociale,  
Znj. Kadrije Krasniqi, Udhëheqëse e Projektit,

---

Komuna e Prishtinës  
Z. Shpend Ahmeti

---